

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Shqipëria e shqiptarëve është slogan i neveritshëm dhe i turpshëm"/ Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/shqiperia-e-shqiptarveeshte-slogan-i-neveritshem-dhe-i-turpshem-ra-i516020
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:28:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 14:58:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ea4e927413cada9e349abcbff6d00312bb27be9f5d19f755a8e3d3d499bf13cb
TEKSTI	8cd20a069d970873188d35f157da826ffac6cc41b3458dcf96dcdc9ece1e7765
PAMJA	e4560551e2989c69c26355015b7be7757e05a63d554d187c7f15e794a355507a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f74280fce7c304774115e7303a795b0f2bedaa9ad6c2540abf5056bb51babdc4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912fff4d1353a313a25f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f74280fce7c304774115e7303a795b0f2bedaa9ad6c2540abf5056bb51babdc4

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

13 MINUTA ME PARE

"Shqipëria e shqiptarëve është slogan i neveritshëm dhe i turpshëm"/ Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës

2 ORE ME PARE

Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplasjet fizikisht me pronarin e ish-hotelit "Mira Mare": Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava

18 ORE ME PARE

Tensione dhe braktisje salle në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranien. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtra të pabaza

22 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

LIVE UPDATES

"Shqipëria e shqiptarëve është slogan i neveritshëm dhe i turpshëm"/ Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës

• Kryeministri i vendit, Edi Rama mori pjesë ditën e sotme në një takim në New York, në mbrëmjen gala të organizuar nga Këshilli për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane. • Gjatë fjalës së tij në këtë takim ai u ndal tek marrëdhënia SHBA-Shqipëri, gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, protestat dhe intergrimi i vendit në BE. • Rama e nisi fjalim e tij, duke u shprehur i zhgënjyer nga SHBA-ja lidhur me qëndrimin e saj ndaj vendit të Hagës për Hashim Thaçin. • Në lidhje me këtë, ai deklaroi se SHBA-ja tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës. • Kryeministri sqaroi se me termin "tradhtuar" nuk nënkuptonte se shqiptarët janë të barabartë në peshë me Shtetet e Bashkuara. • Këtë ai e argumenton duke thënë se marrëdhënia e gjatë mes shqiptarëve dhe SHBA-së e bën atë të ndihet i zhgënjyer nga mënyra se si është trajtuar çështja e Thaçit. • Kryeministri Rama foli për Bonot e Diasporës, të cilat sipas tij, synojnë të rrisin më tej përfshirjen dhe investimet e shqiptarëve jashtë vendit. • Gjatë fjalës së tij në një takim në New York ai u shpreh se në Shqipëri do investohen miliarda jo vetëm me projektin e Kushner, por edhe me projekte më të mëdha. • Ai u ndal edhe tek korrupsioni, për të cilin tha se sistemi demokratik i Shqipërisë ka nisur të ndërtojë imunitet ndaj korrupsionit. • Rama foli edhe për protesta, por jo për thelbin e tyre, duke thënë se qytetarët shqiptarë po protestojnë për biodiversitetin. • Ai ka sulmet ndaj protestuesve të cilët ndodhen në shesh prej më shumë se tre muajsh, duke thënë se "Shqipëria e shqiptarëve", është një slogan i neveritshëm dhe i turpshëm, duke thënë se vendi i përket Zotit dhe mikut.

4 artikuj për këtë temë.

58 MINUTA ME PARE

"Vendi i përket Zotit dhe mikut"/ Rama sulmon protestuesit: Shqipëria e shqiptarëve, slogan i neveritshëm dhe i turpshëm



Edi Rama

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje


AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë

...të tregimit të Ramës, por Rama në një samitë ka pretenduar të shprehë nënën e tij me anën e muajsh, duke thënë se "Shqipëria e shqiptarëve", është një slogan i neveritshëm dhe i turpshëm. Në fjalimin e tij gjatë një takimi në New York, ai tha se vendi i përket Zotit dhe mikut.

Më tej, ai foli edhe për sukseset e qeverisë së tij, duke thënë se PBB-ja është rritur me 2.5 herë, ndërsa shtoi se vendi po përgaditet edhe për projekte më të mëdha se ai i Kushner. Kryeministri foli edhe për mjedisin dhe biodiversitetin, duke argumentuar se rritja e zonave të mbrojtura, ndalimi i gjuetisë dhe rikuperimi i pyjeve kanë sjellë një ndryshim të rëndësishëm në vend.

Në fund Rama u ndal edhe tek diaspora, për të cilën tha se qeveria po përgatit "Bonon e Diasporës". Sipas tij ajo synon të rrisë pjesëmarrjen dhe investimet e shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit.



Edi Rama: Duke lënë pas pirgje zogj të ngordhur që u kthyen në turpin e vendit tonë sot vendi proteston për biodiversitetin pasi ndalua gjuetinë, pasi rritëm zonat e mbrojtura pasi ndalua shfrytëzimin e pyjeve, pasi rritëm 3 fish numrin e shpendëve dhe kafshëve në vendin tonë, pasi rritëm shumëfish sipërfaqen e pyjeve të rikuperuara tashmë kemi një ndjesi dhe Shqipëri të re.

Njerëzit duan më shumë. Shqipëria ku njerëzit jetonin me idenë se mirë është se mund të jetë më keq. Nuk ekziston më. Sukses i madh siç është sigurisht një sukses i madh që jemi shumë afër se ç'ishim me diasporën. Po përgatisim bonon e diasporës që ta përfshijmë në tjetër nivel pjesëmarrjen e diasporës në vend.

E nisëm me 12 mld dollarë PBB. Është rritur me 2.5 herë. Duke sjellë më shumë investime. Po përgatitemi të hedhim në vend mld jo vetëm me projektin e famshëm Kushner, por edhe me të tjera të mëdha që kemi në proces e sipër. Gjërat janë shumë të qarta që kemi kaluar një kohë poshtërimi, tregoheshim me gisht në Europë. Kushdo që donte të fitonte një palë zgjedhje në Europë e kishte të lehtë të tregonte shqiptarët si delja e zezë. Na duhet të bëjmë zgjedhje. Për të ëndërruar shumë më tepër ta bëjmë PBB aq ta lartë, shumë më tepër me më shumë kurajo.

Pa përjashtuar në një betejë të pakuptimtë ideologjike zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit pa fajësuar të huajt që vijnë e po na marrin tokën. Kam dëgjuar slogan më të neveritshëm dhe turpshëm Shqipëria u përket shqiptarëve. Nëse do ishte e njëjta gjë ku shqiptarët shkuan përtej nuk do kishim mundur të bënim asgjë. Imagjinojeni nëse Amerika do u bërtiste shqiptarët të shkojnë në shtëpi. Apo italianët grekët? Ku do ishim? Në një epokë neonaziste 4.0. jo, Shqipëria i përket Zotit dhe mikut. Është shtëpia e shqiptarit, por duhet të ketë vend për gjithkënd që bujt e vjen./Dosja.al

1 ORE ME PARE

“Po përgatisim Bonot e Diasporës”/ Rama: Në Shqipëri do investohen miliarda jo vetëm me projektin e Kushner, por edhe me projekte të tjera



(VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit



AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 07:44

"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

më të klikuarat

"Të q'fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

Plagosja e të riut në Lezhë/ Pagesa e riparimit të makinës bëhet "mollë sherri", kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin! Autorët u larguan me makinë, babë e bir në kërkim (EMRAT)

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kryeministri Rama mban sot fjalimin e tij në hapje të debatit

insights

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Edvin Krasniqi



Edi Rama

Sa gati është biznesi
shqiptar për tu
përshtatur me
tregun e BE-së?


Moti

Powered by  tomorrow.

SHBA- Kryeministri Edi Rama foli për Bonot e Diasporës, të cilat sipas tij, synojnë të rrisin më tej përfshirjen dhe investimet e shqiptarëve jashtë vendit. Gjatë fjalës së tij në një takim në New York ai u shpreh se në Shqipëri do investohen miliarda jo vetëm me projektin e Kushner, por edhe me projekte më të mëdha.

Ai u ndal edhe tek korrupsioni, për të cilin tha se sistemi demokratik i Shqipërisë ka nisur të ndërtojë imunitet ndaj korrupsionit. Rama foli edhe për protesta, por jo për thelbin e tyre, duke thënë se qytetarët shqiptarë po protestojnë për biodiversitetin.

Rama deklaroi se Shqipëria ka kaluar nga një periudhë ku shihej me skepticizëm në Europë drejt një faze ku vendi duhet të synojë më shumë dhe të mos ketë frikë të ëndërrojë për të ardhmen.



Edi Rama: Është viti i pestë a i gjashtë që kemi aeroportin më të madh në rajon, duke qenë shumë i madh jo vetëm në terma relative, por edhe në shifra absolute, me më shumë udhëtarë se aeroporti i Beogradit, që ka qenë më i madhi në rajon. Kjo nuk është e thjeshtë që ta përtypin të gjithë. Kush është Shqipëria që të rritet dhe të tregojë këtë kapacitet për ndryshim? Ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu.

Nuk po them që nuk kemi probleme. Ne shqiptarët, atë çfarë e shohim si problem, partnerët europianë e shohin si sukses. A mund të ketë një vend më shumë korrupsion në rast se korrupsioni luftohet çdo ditë? Lufta kundër korrupsionit të ndodhë çdo ditë. Jo, nuk është.

Sot, sistemi demokratik i Shqipërisë ka nisur të ndërtojë imunitet ndaj korrupsionit. Nuk është fjala thjesht për një udhëheqës apo qeveri, është për një sistem që funksionon, me gjithë nevojën për t'u rritur dhe pjekur më tej. Çdo ditë nuk është më vendi ku mund të ecësh dorë më dorë me korrupsionin.

Në një vend ku 10 vjet më parë kafshët dhe shpendët masakroheshin nga mijëra gjuetarë që kalonin nga kufiri ynë, që të bënin festë pa asnjë rregull dhe kontroll dhe të vrisnin majtas e djathtas, duke lënë qindra pirgje zogjsh të ngordhur, sot vendi proteston për biodiversitetin.

Pasi rritëm trefish numrin e shpendëve dhe kafshëve në vendin tonë, pasi rritëm shumëfish se kurrë më parë sipërfaqen e pyjeve të rikupëruara, tashmë kemi një ndjesi të re. Sot këtu është mirë, se mund të jetë më mirë, ashtu siç është sukses që jemi shumë herë më afër se ishim me diasporën shqiptare.

Po përgatisim Bonot e Diasporës që ta çojmë në një tjetër nivel përfshirjen e diasporës sa i përket pjesëmarrjes. E nisëm me 12 miliardë, janë vetëm 2 vjet dhe do të rriten më shumë, duke sjellë më shumë investime.

Do të përgatitemi të hedhim miliarda jo vetëm me projektin e Kushnerit, por edhe me projekte të mëdha. Kemi tejkaluar një epokë poshtërimi, ku ishim ata që tregoheshim me gisht në Europë. Na duhet të bëjmë zgjedhjen për të ëndërruar më tepër, pa pasur frikë./Dosja.al

1 ORE ME PARE


“Viti i 6 që kemi aeroportin më të madh në rajon”/ Rama nga SHBA: Ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu



Edi Rama

SHBA- Kryeministri Edi Rama tha se ky është viti i 6 që Shqipëria ka aeroportin më të madh në rajon. Gjatë fjalës së tij në një takim në New York, Rama u shpreh se ky aeroport ka më shumë udhëtarë se sa ai në Beograd, duke theksuar se ka forca që nuk kanë dëshirë ta shohin këtë zhvillim.

Kryeministri pranoi se Shqipëria vijon të ketë problematika, ndërsa u ndal te çështja e korrupsionit. Sipas tij, ajo që shqiptarët e konsiderojnë problem, partnerët europianë e shohin si sukses. Në fund, ai tha se vendi ka bërë ndryshime të rëndësishme, por sukcesi i arritur nuk është diçka që pranohet lehtësisht nga të gjithë.



Edi Rama: Kur them të tradhtuar, jemi të gjithë të vegjël. Ne kemi kremtuar dhe do të kremtojnë gjithmonë faktin se ne shqiptarët jemi miq të fortë. Prandaj ndihem i tradhtuar. Kjo farcë të niste. Ndjesë gjeneral. Ju jam mirënjohës për gjithçka që keni bërë në kapacitetin tuaj personal. Takohemi sërish sonte, por ne zhgënjyem një mik të madh. Më lejoni të ndryshoj temë. Atë që tha Martini, për atdheun tonë, sa shumë ka ndryshuar për këto vite. Ka të bëjë me faktin se sonte ne duhet të përballemi me një fakt të thjeshtë, askush nuk ta fal suksesin

Është viti i 5 apo i 6 që kemi aeroportin më të madh në rajon. Duke qenë shumë i madh jo vetëm në terma relative, në rritje në Europë, por edhe në shifra. Më shumë udhëtarë se sa ai në Beograd. Sigurisht që kjo nuk është shumë e thjeshtë, që ta përtypin të gjithë, se kush jemi ne, kush është Shqipëria që të tregojë një ndryshim të tillë. Ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu. Nuk po përpiqem të them se nuk kemi mangësi. Martini në fjalën e tij nuk harroi të përmendte korrupsionin. Por e çuditshme është se ne shqiptarët, ajo çfarë shqiptarët e shohin si problem, partnerët europianë e shohin si sukses. A është e vërtetë./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës!





Edi Rama

SHBA- Kryeministri i vendit, Edi Rama ka deklaruar ditën e sotme se ish-Presidenti i SHBA-së, Joe Biden e ka tradhtuar Hashim Thaçin, i cili u dënua me 25 vite burg nga Dhomat e Specializuara për Kosovën në Hagë. Gjatë fjalës së tij në një takim në Neë York, në mbrëmjen gala të organizuar nga Këshilli për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane, Rama tha se ky vend nuk bëri më të mirën për Thaçin.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.